

RREGULLORE

Për

përrjashtimin në bllok të kategorive e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike¹

Kreu I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përfitimi nga përjashtimi në bllok i marrëveshjeve, ndërmjet ndërmarrjeve, në sektorin e mjeteve motorike, (i cili është një sektor që përfshin si mjetet motorike të pasagjerëve, sikurse makinat, ashtu dhe ato tregtare). Synimi i këtij përjashtimi është ulja e kostove për ndërmarrjet pjesëmarrëse, duke siguruar një mbikëqyrje të tregjeve në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 2

Fusha e Zbatimit

1. Sektori i mjeteve motorike përfshin:
 - a)shpërndarjen e mjeteve të reja motorike;
 - b)shpërndarjen e pjesëve të këmbimit; si dhe
 - c)shërbimet e riparimit, e të mirëmbajtjes së mjeteve motorike;

duke mundësuar kështu përcaktimin e një kategorie të marrëveshjeve vertikale në sektorin e mjeteve motorike.

2. Kjo kategori marrëveshjeje përfshin:
 - a) marrëveshjet vertikale për blerjen, shitjen ose rishitjen e mjeteve motorike të reja;

¹ 32010R0461; Rregullorja e Komisionit Nr 461/2010 e datës 27 Maj 2010 Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike

- b) marrëveshjet vertikale për blerjen, shitjen ose rishitjen e pjesëve të këmbimit për mjetet motorike; si dhe
- c) marrëveshjet vertikale për ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe të riparimit për këto mjete;
- d) marrëveshjet vertikale që përmbajnë klauzola lidhur me dhënien, ose përdorimin e të drejtave të pronësisë Intelektuale.

Marrëveshjet e mësipërme përfshihen në këtë kategori kur ato janë lidhur:

- ndërmjet ndërmarrjeve jo-konkurruese;
- ndërmjet disa konkurrentëve të caktuar; ose
- ndërmjet bashkimesh të shitësve me pakicë, ose riparuesve.

3. Marrëveshjet vertikale të kësaj kategorie mund të përmirësojnë efikasitetin ekonomik brenda zinxhirit të prodhimit, ose shpërndarjes, duke lehtësuar koordinimin më të mirë ndërmjet ndërmarrjeve pjesëmarrëse. Në veçanti, ato mund të çojnë në një zvogëlim të kostove të transaksioneve dhe shpërndarjes së pjesëve të këmbimit dhe në një optimizim të shitjeve të tyre dhe niveleve të investimit.
4. Me synim që të përmbushet qëllimi i kësaj rregulloreje të përjashtimit në bllok, Autoriteti i Konkurrencës duhet të ketë parasysh kushtet e konkurrencës në këtë sektor. Pra, do duhet të dallohen marrëveshjet e shpërndarjes së mjeteve të reja motorike nga marrëveshjet e shërbimit për riparimin dhe mirëmbajtjen, ose ato të shpërndarjes së pjesëve të këmbimit.
5. Për sa i përket marrëveshjeve të shpërndarjes së mjeteve të reja motorike, ato nuk paraqesin ndonjë kufizim të ndjeshëm për konkurrencën, i cili do ta dallonte këtë sektor nga sektorët e tjerë ekonomikë dhe që do të kërkonte zbatimin e rregullave të ndryshme dhe shumë më strikte nga ato që zbatohen nga rregullorja (edhe kjo e llojit të *Përjashtimit në Bllok*) "*Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara*".
6. Në përmbushjen e qëllimit të kësaj rregulloreje, vetëm për sa i përket marrëveshjeve të shpërndarjes së pjesëve të këmbimit dhe atyre të shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes, do të mbahen parasysh karakteristikat e veçanta të këtyre tregjeve dytësore të mjeteve motorike si më poshtë:
 - Rritja e çmimeve për punët individuale të riparimit paraqitet vetëm pjesërisht në: i) rritjen e sigurisë së makinave moderne dhe ii) në zgjatjen e intervaleve të shërbimeve;
 - Ndryshimet e fundit vijnë si rezultat i evoluimit teknologjik dhe kompleksitetit në rritje, si dhe me sigurinë e pajisjeve që prodhuesit e mjeteve i blejnë nga ofruesi origjinal i tyre. Këta ofrues shesin produktet e tyre si pjesë këmbimi në tregjet dytësore edhe nëpërmjet prodhuesve të mjeteve, të autorizuar për rrjetet e riparuesve, edhe nëpërmjet kanaleve të pavarura,

duke paraqitur kështu një forcë të rëndësishme konkurruese në tregjet dytësore të mjeteve motorike.

- Pjesën më të lartë të shpenzimeve totale të përdoruesve të mjeteve motorike, i përfaqësojnë kostot për riparimet dhe shërbimet e mirëmbajtjes të këtyre mjeteve, që rëndojnë mbi klientët .

- 7.** Konkurrenca efektive në tregjet dytësore përkatëse: a) të blerjes dhe shitjes së pjesëve të këmbimit, dhe b) të shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes për mjetet motorike; do të varet nga shkalla e konkurrencës midis riparuesve të autorizuar, (d.m.th ata që ushtrojnë aktivitet brenda rrjetit të riparimeve të krijuar direkt ose indirekt nga prodhuesit e mjeteve, ashtu si dhe ndërmjet operatorëve të autorizuar), ose atyre të pavarur, përfshirë ofruesit dhe riparuesit e pavarur të pjesëve të këmbimit. Mundësia e këtyre të fundit për të konkurruar, do të varet nga aksesit i pakufizuar mbi inputet thelbësore, të tilla si pjesë këmbimi dhe informacion teknik.
- 8.** Duke pasur parasysh këto specifika, pjesa e tregut prej 30% (përcaktuar edhe në Rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikat e bashkërenduara”), do të konsiderohet kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për të siguruar që përfitimet nga përjashtimet në bllok do t’u rezervohen vetëm atyre marrëveshjeve vertikale për: i) shpërndarjen e pjesëve të këmbimit; dhe ii) për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes; të cilat presupozohen me siguri të plotë se janë brenda kushteve për përjashtimin në bllok.
- 9.** Marrëveshjet vertikale të mjeteve motorike, për shpërndarjen e pjesëve të këmbimit dhe shërbimet mbi riparimin dhe mirëmbajtjen, duhet të përfitojnë nga përjashtimi në bllok, vetëm nëse ato përmbushin kërkesa strikte në lidhje me mos shkaktimin e kufizimeve të rënda të konkurrencës, që mund të kufizojnë ofertën dhe përdorimin e pjesëve të këmbimit në tregjet dytësore të mjeteve motorike.
- 10.** Ndërkohë, përjashtimi në bllok nuk duhet të jepet për marrëveshjet që kufizojnë shitjet e pjesëve të këmbimit nga anëtarët e rrjetit të shpërndarjes, të përzgjedhur nga prodhuesit e mjeteve, tek riparuesit e pavarur, të cilët i përdorin ato për shërbimet e riparim-mirëmbajtjes. Pa një akses të tillë mbi pjesët të këmbimit, riparuesit e pavarur nuk do të jenë në gjendje të konkurrojnë efektivisht me riparuesit e autorizuar, për sa kohë ata nuk mund t’u sigurojnë konsumatorëve një shërbim me cilësi të mirë, i cili kontribuon në mirë-funksionimin e sigurtë dhe të besueshëm të mjeteve motorike.
- 11.** Për më tepër, me qëllim që të sigurohet konkurrenca efektive në tregjet e riparim-mirëmbajtjes dhe ti lejohet riparuesve që t’u ofrojnë përdoruesve fundor pjesë këmbimi konkurruese, përjashtimi në bllok nuk do të përfshijë marrëveshjet vertikale kur ato kufizojnë mundësinë e prodhuesve të pjesëve të këmbimit për ti shitur ato tek riparuesit e autorizuar brenda

rrjetit të shpërndarjes të prodhuesit të mjeteve, tek shpërndarësit e pavarur të tyre, tek riparuesit e pavarur, ose tek përdoruesit fundor.

- 12.** Kjo nuk do të ndikojë mbi mundësinë e prodhuesve të pjesëve të këmbimit, ose mbi mundësinë e prodhuesve të mjeteve motorike, për t'u kërkuar riparuesve të autorizuar (brenda rrjetit të shpërndarjes), të përdorin vetëm pjesë këmbimi që kanë të njëjtën cilësi përbërësish me ato të përdorura për mjetet motorike të caktuara. Nga këndvështrimi i prodhuesve të mjeteve do duhet të jenë pjesë e përjashtimit marrëveshjet që përmbajnë detyrime mbi riparuesit e autorizuar, për të përdorur vetëm pjesë këmbimi të ofruara nga prodhuesi i mjeteve për këta riparues, të cilat (sipas garancisë) përfshihen direkt në riparimin e tyre, shërbimet e lira dhe rikryerjen e veprimeve.
- 13.** Përjashtimi në bllok nuk duhet të përfshijë marrëveshjet nga të cilat një prodhues i mjeteve motorike kufizon mundësinë e prodhuesit të komponentëve, (ose pjesëve origjinale të këmbimit), që të zëvendësojnë efektivisht markën tregtare ose logon e këtyre pjesëve dhe në një mënyrë të dukshme, me qëllim që t'u lehtësohet riparuesve të autorizuar dhe të pavarur, si dhe përdoruesve fundor, identifikimi i prodhuesit të komponentëve të mjeteve motorike, (ose të pjesëve të këmbimit), në mënyrë që të përzgjedhin ose zëvendësojnë ndërmjet alternativave.

Neni 3

Përkufizime

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Përjashtim në bllok" nënkupton përjashtimin prej zbatimit të nenit 4 të ligjit, i dhënë për kategori të caktuara të marrëveshjeve vertikale në sektorin e mjeteve motorike.
- b) "Marrëveshje vertikale" nënkupton një marrëveshje ose praktikë të bashkërenduar të lidhur midis dy apo më shumë ndërmarrjeve, ku secila prej tyre ushtron aktivitet, për qëllime të marrëveshjes ose praktikës së bashkërenduar, në një nivel të ndryshëm të zinxhirit të prodhimit, ose shpërndarjes, dhe në lidhje me kushtet sipas të cilave palët mund të blejnë, shesin ose rishesin produkte të caktuara në sektorin e mjeteve motorike;
- c) "Kufizimi vertikal" nënkupton një kufizim të konkurrencës në një marrëveshje vertikale sipas objektit të nenit 4 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës";
- d) "Riparues i autorizuar" nënkupton një ofrues të shërbimeve të riparimeve ose të mirëmbajtjes për mjetet motorike, të cilat ushtrojnë veprimtari brenda sistemit të shpërndarjes, të vendosur nga ofruesi i mjeteve motorike;
- e) "Shpërndarës i autorizuar" nënkupton një shpërndarës të pjesëve të këmbimit për mjetet motorike, të cilat ushtrojnë veprimtari brenda sistemit të shpërndarjes të krijuar nga ofruesi i mjeteve motorike;
- f) "Riparues i pavarur" nënkupton:

- 1) një ofruer të shërbimeve të riparim-mirëmbajtjes të mjeteve motorike, i cili nuk ushtron veprimtari brenda rrjetit të shpërndarjes, i krijuar nga ofruesi i mjeteve motorike, për të cilat ai siguron riparimin dhe mirëmbajtjen;
- 2) një riparues të autorizuar brenda rrjetit të shpërndarjes të një ofruesi përkatës, deri në masën që siguron shërbimet e riparimit -mirëmbajtjes për mjetet motorike, në lidhje me të cilat ai nuk është një anëtar i rrjetit të shpërndarjes së ofruesit në fjalë;
- g) "shpërndarës i pavarur" nënkupton:
 - 1) një shpërndarës të pjesëve të këmbimit për mjetet motorike që nuk ushtron aktivitet brenda rrjetit të shpërndarjes, i krijuar nga ofruesi i mjeteve motorike për të cilat ai shpërndan pjesët e këmbimit;
 - 2) Një shpërndarës i autorizuar brenda rrjetit të shpërndarjes të një ofruesi të dhënë, deri në masën që ai shpërndan pjesë këmbimi për mjetet motorike në lidhje të të cilat ai nuk është një anëtar i rrjetit në fjalë të shpërndarjes;

(gj) "Mjet motorik" nënkupton një mjet vetëlëvizës i destinuar për përdorim në rrugë publike dhe që ka tre ose më shumë rrota dhe që pjesa më e rëndësishme e tij është motorri me djegie të brendshme;

(h) "Pjesë këmbimi" nënkupton pajisjet, të cilat instalohen në/mbi një mjet motorik me qëllim që të zëvendësojnë përbërësit e atij mjeti, përfshirë këtu edhe mallra të tilla si lubrifikantë (vajra, graso, etj), të cilat janë të nevojshëm për përdorimin e mjetit motorik, me përjashtim të karburanteve;

(i) "Rrjet shpërndarjeje i të përzgjedhurve" nënkupton një rrjet shpërndarjeje ku ofruesi ndërmerr nismën të shesë produktet e kontratës drejtpërdrejtë/jodrejtpërdrejtë, vetëm tek shpërndarësit e përzgjedhur, mbi baza të kritereve të veçantë dhe ku këta shpërndarës nuk kanë të drejtë të shesin këto produkte tek shpërndarësit e paautorizuar, brenda territorit të rezervuar nga/për ofruesin që ushtron veprimtari në atë rrjet.

3. Për qëllime të kësaj rregulloreje termat "Ndërmarrje" "ofruer", "prodhues": dhe "blerës" përfshihen në nocionin e *ndërmarrjes së lidhur*, përcaktuar vijimisht.

"Ndërmarrje e lidhur" nënkupton atë ndërmarrje, e cila drejtpërdrejtë ose jo, ka fuqinë të:

- a) ushtrojë më shumë se gjysmën e të drejtës së votës, ose
- b) caktojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të organeve drejtuese të ndërmarrjes, ose
- c) administrojë veprimtarinë e ndërmarrjes.

4. "Tregje dytësore" u referohen si term, tregut të ri të mallrave që krijohet për përmirësimin, ose mirëmbajtjen e produktit të shitur më parë. Ky term zakonisht përdoret në industrinë e automjeteve, në të cilën zotëruesit e pjesëve të këmbimit të makinave, të

tilla si mbulesat për pjesën e ekspozuar të rrotave të makinës, të cilat nuk janë prodhuar nga prodhuesi origjinal i mjeteve motorike.

Kreu II

Marrëveshjet vertikale në tregjet dytësore të mjeteve motorike

Neni 4

Përrjashtimi

1. Në zbatim të nenit 6 të Ligjit dhe të kësaj rregulloreje, neni 4 i ligjit nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale, (që lidhen me kushtet ku palët mund të blejnë, shesin, ose rishesin pjesë këmbimi për mjetet motorike, ose të sigurojnë shërbimet e riparimit-mirëmbajtjes për mjetet motorike), të cilat plotësojnë kushtet për përjashtim, sipas rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara” dhe nuk përmbajnë ndonjë dispozitë për kufizime të rënda sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.
2. Ky përjashtim, do të zbatohet deri në masën që këto marrëveshje nuk përmbajnë kufizime të rënda vertikale.

Neni 5

Kufizime të rënda të papërfshira tek përfitimet e përjashtimeve në bllok

Përjashtimi i parashikuar në nenin 4 nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale, të cilat, drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejtë, veçmas ose kombinuar me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve kanë si synim:

1. Kufizimin e shitjeve të pjesëve të këmbimit për mjetet motorike nga anëtarët e rrjetit shpërndarës të të përzgjedhurve tek riparues të pavarur, të cilët i përdorin këto pjesë për riparim-mirëmbajtjen e mjeteve motorike;
2. Kufizimin si pasojë e rënies dakord ndërmjet: (i)- **ofruesit** të pjesëve të këmbimit, mjeteve të riparimit, (ose ato të përcaktuara si të tilla), ose mjete të tjera dhe (ii)- **prodhuesit** të mjeteve motorike, lidhur me mundësinë e ofruesit për t'i shitur këto mallra tek një shpërndarës i autorizuar, (ose i pavarur); ose tek riparuesi i autorizuar, (apo i pavarur), ose tek përdoruesi fundor;
3. Kufizimi, si pasojë e rënies dakord ndërmjet: i) një **prodhuesi** të mjeteve motorike, i cili përdor pjesët për montimin fillestar të mjeteve motorike dhe ii) **ofruesit** të këtyre pjesëve, lidhur me mundësinë e ofruesit për të zëvendësuar markën e tij tregtare, ose logon në mënyrë efektive dhe lehtësisht të dukshme për pjesët e ofruara, ose për pjesët e këmbimit.

Neni 6

Moszbatimi i rregullores

Kjo rregullore nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale që përmbajnë kufizime të veçanta në lidhje me tregjet kur rrjete paralele të kufizimeve të ngjashme vertikale mbulojnë më tepër se 50 % të tregut përkatës.

Neni 7

Zbatimi i rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”

Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara” do të zbatohet vetëm për marrëveshjet vertikale që lidhen me blerjen, shitjen ose rishitjen e mjeteve të reja motorike.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.